



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Kom.Dh.Shk.II.nr.1340/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË, Dhoma e Shkallës së Dytë -gjqytari individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit ....AD, me numër regjistrimit biznesit .... me seli në ....., Sofje ....., Republika e Bullgarisë me përfaqësues të autorizuar Jupolli&Associates shpk me avokat Basri Jupolli dhe Arlind Jupolli nga Prishtina kundër debitorit Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) Autoriteti i Likuidimit,Administrator i ....C, me bazë juridike: përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit e paraqitur kundër Konkluzionit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.90/20, të datës 23.06.2020, jashtë seancës gjyqësore me datë 23.08.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET si e themeltë ankesa e kreditorit të përmbarimit ....AD, me numër regjistrimit biznesit .... me seli në ....., Sofje ....., Republika e Bullgarisë.

II. Shfuqizohet Konkluzioni i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.90/20 i datës 23.06.2020 me të cilin është pezulluar procedura e përmbarimit ndaj debitorit të përmbarimit AKP-së-Autoriteti i Likuidimit, Administrator i ....C.

III. Refuzohet prapësimi i debitorit AKP-së-Autoriteti i Likuidimit, Administrator i ....C, i parashtruar kundër Urdhërit Përmbarimor me nr.P.nr.001/2020 i datës 03.01.2020 dhe Lejohet vazhdimi i procedurës përmbarimore sipas Urdhrit Përmbarimor me nr.P.nr.001/2020 dt.03.01.2020 i lejuar nga përmbaruesi privat

A R S Y E T I M

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me Konkluzionin e ankimuar PPP.nr.90/20 të datës 23.06.2020, e ka pezulluar procedurën në këtë çështje përmbarimore, deri sa të përfundoj procedura e likuidimit ndaj debitorit të përmbarimit Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP),Autoriteti i Likuidimit administrator i ....., dhe pas përfundimit të procedurës së likuidimit ndaj debitorit do të vazhdoj procedura përmbarimore.

Kundër këtij konkluzioni kreditori përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka parashtruar ankesë, me pretendimet se Gjykata Themelore në Prishtinë përmes Aktvendimit I.C nr.38/2014 ka njohur dhe lejuar ekzekutimin e vendimit të Arbitrazhit të lëshuar në favor të kreditorit. Duke vepruar në përputhje me Ligjin për Arbitrazhin dhe nenin 22 par.1 nënp.1.5 të LPP-së, nenin 23 par.1 të LPP-së, është lëshuar Urdhëri Përmbarimor nga organi përmbarues përmes të cilit është lejuar përmbarimi sipas vendimit të Arbitrazhit të njohur dhe shpallur të ekzekutueshëm nga Gjykatat e Kosovës. Në kundërshtim me LPP dhe Ligjin për Arbitrazhin, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm nxjerr konkluzionin e parë me dt.23.06.2020 me të cilin pezullon procedurën në qështjen përmbarimore me arsyetimin s e e njëjta pezullohet deri sa të përfundoj procedura e likuidimit ndaj ..... -Vushtri. Mungesa e bazës ligjore edhe në Konkluzionin e parë datës 23.06.2020 si dhe në Konkluzionin e ankimuar sipas kësaj ankese konsiston së atë se: neni 35 par.1 i LPP shprehimisht përcakton se organi përmbarues nuk mund të ndërprere procedurën përmbarimore me qëllim që të pres vendimin e gjykatës kompetente apo të ndonjë organi tjetër për qështjen paraprake. Me veprimet e saj gjykata e shkallës ë parë ka rrezikuar në tërësi mundësin e kreditorit për të siguruar kthimin e mjeteve për shkak se debitori është duke realizuar shpërndarje të kreditorët tjerë duke injoruar në tërësi kërkesën e kreditorit të konfirmuar nga arbitrazhi ndërkombëtar dhe gjykata vendore, e poashtu Qeveria e Kosovës në planin e aprovuar qeverisës 2021-2025 qartazi ka theksuar në faqen 8 par 2 se e njëjta do të shuaj debitorin, veprim i cili qartazi rrezikon të drejtën dhe mundësin e kreditorit për të realizuar të drejtat e tij. I ka propozuar gjykatës që të nxjerr aktvendim me të cilin anulon konkluzionin PPP.nr.90/20 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, dhe të lejon vazhdimin e procedurës përmbarimore sipas urdhrin përmbarimor të përmbaruesit privat nr.001/20 dt.03.01.2020

Debitori në parashtresën e datës 29.04.2021 dorëzuar gjykatës, thekson se mbetet prapa qëndrimeve të shprehura edhe në prapësimin që është bërë në lidhje me këtë lëndë. Në parashtresë debitori referohet në nenin 10 par.1 të Shtojcës së Ligjit për AKP nr.04/L-034. Autoriteti i likuidimit thekson se ndërmarrja në fjalë është akoma në procedurën e likuidimit dhe kjo fazë nuk është e mbyllur. Raporti i shpërndarjes në të cilën kreditori thirret nuk nënkupton se ndërmarrja ka përfunduar procedurat e likuidimit. Autoriteti i likuidimit kërkon që të mbetet në fuqi vendimi i shkallës së parë.

Gjykata Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, konkluzionin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se kreditori ....AD, me numër regjistrimit biznesit .... me seli në ....., Sofje ....., Republika e Bullgarisë, me datën 03.01.2020, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) Autoriteti i Likuidimit, Administrator i ....C, në bazë të dokumentit përmbarues-Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit pranë odës Ekonomike Ndërkombëtare në Paris nr.15386/FM

datës 05 nëntor 2010, i cili është njohur dhe është shpallur i ekzekutueshëm nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje ekonomike, me Aktvendimin C.nr.38/2014 dt.09.07.2014, mirëpo debitori asnjëherë nuk i është përgjigjur këtij obligimi dhe asnjëherë nuk e ka përmbushur borxhin që rrjedh nga ky vendim.

Përmbartuesi Privat Ilir Mulhaxha me seli në Prishtinë duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit ka lejuar përmbartimin me urdhrin P.nr.001/2020 të datës 03.01.2020, ndërsa kundër këtij urdhri debitori ka ushtruar prapësim me datën 16.01.2020.

Përgjigje në prapësim ka parashtruar kreditori me datë 23.0.2020, me propozim bërë Gjykatës së shkallës së dytë që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar dhe të lihet në fuqi urdhri përmbartimor P.nr.001/2020 dt.03.01.2020 dhe të lejohet vazhdimi i procedurës përmbartimore.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm duke vendosur sipas prapësimit të debitorit, me Konkluzionin PPP.nr.90/20 dt.23.06.2020 ka pezulluar procedurën në këtë qështje përmbartimore, deri sa të përfundoj procedura e likuidimit ndaj debitorit të përmbartimit Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Autoriteti i Likuidimit administrator i ...., dhe pas përfundimit të procedurës së likuidimit ndaj debitorit do të vazhdoj procedura përmbartimore.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka bërë përshkrimin e pretendimeve të debitorit dhe kreditorit dhe në fund nxjerr një përfundim të shkurt se procedura në këtë qështje përmbartimore duhet të pezullohet deri sa të përfundoj procedura e likuidimit ndaj debitorit të përmbartimit.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, një qëndrim dhe përfundimin juridik të tillë gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se konkluzioni i atakuar është përfshirë në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 182.2 pika n), 183, 127 të LPK-së, e lidhur me nenin 29 paragrafi 1 pika 1.3 e lidhur me nenin 40 dhe 43 paragrafi 4 dhe 70 të LPP-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë nuk mund ta pranojë mënyrën e vendosjes nga ana e gjykatës së shkallës së parë sipas konkluzionit të ankimuar, për arsyeje se kjo gjykatë vlerëson se konkluzioni i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) e LPK-së. Gjendja faktike rezulton të mos jetë vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë me çka ka ardhur edhe deri te aplikimi i gabuar i të drejtës materiale.

Dhoma e Shkallës së Dytë nuk mund ta pranojë këtë qëndrim dhe përfundim në Konkluzionin e gjykatës së shkallës së parë si të ligjshëm dhe të drejtë, me një arsyetim të mangët se procedura në këtë qështje përmbartimore duhet të pezullohet deri sa të përfundoj procedura e likuidimit ndaj debitorit të përmbartimit. Dhoma e Shkallës së Dytë në këtë rast nga shkresat e lëndës vërteton se gjykata e shkallës së parë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore dhe Ligjit 02/L-75 për Arbitrazhin, ka nxjerr Konkluzion me të cilin ka ndërprerë dhe mohuar të drejtën e realizimit të kreditorit sipas vendimit të

Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit pranë Odës Ekonomike Ndërkombëtare në Paris nr.15386/FM datës 05 Nëntor 2010, i cili vendim është njohur dhe është i shpallur i ekzekutueshëm nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje ekonomike, me Aktvendimin I.C. nr.38/2014 datës 09.07.2014

Dispozita e nenit 39 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit 02/L-75 për Arbitrazhin parasheh: Gjykatat e Kosovës i njohin vendimet e arbitrazhit të nxjerra jashtë Kosovës si të plotfuqishme dhe i ekzekutojnë ato nëse vendimet në fjalë janë njohur dhe janë shpallur të ekzekutueshëm sipas paragrafëve 2 deri 5 të këtij neni. Kërkesa për njohjen dhe ekzekutimin e një vendimi të arbitrazhit të nxjerrur jashtë Kosovës i paraqitet Gjykatës Ekonomike.

Dhoma e shkallës së dytë, pas vlerësimit të shkresave të lëndës ka gjetur se, debitori të njëjtin prapësim lidhur me mos-përfundimin e procedurës së likuidimit e ka parashtruar edhe në procedurën e njohjes dhe lejimit të ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit, dhe Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Themelore në Prishtinë e ka trajtuar këtë çështje dhe ka vendosur me Aktvendimin I.C.nr.384/2014 dt.09.07.2014, dhe kjo çështje nuk mund të jetë përsëri objekt shqyrtimi në një procedurë tjetër gjyqësore. Sipas Ligjit për Arbitrazhin (Ligji 02/L-75), vendimi i Gjykatës me të cilin është njohur dhe lejuar ekzekutimi i vendimit të arbitrazhit nuk mund të atakohet me asnjë mjet juridik. Dispozitat e Nenit 36.1, 36.3 dhe nenit 37.2 të Ligjit për Arbitrazhin (Ligji 02/L-75) përcaktojnë se, pala mundet me padi të kërkojë anulimin e vendimit të tribunalit të arbitrazhit, brenda 90 ditësh nga dita e pranimin të vendimit të arbitrazhit, për shkaqet e parapara me Nenit 36.2 të Ligjit. Kundër aktvendimit të Gjykatës me të cilin vendoset lidhur me padinë për anulimin e vendimit të arbitrazhit, sipas Nenit 37.3 të Ligjit për Arbitrazhin, lejohet ankesa. Por e njëjta dispozitë përcakton se, për të gjitha **aktvendimet tjera** të nxjerra nga gjykata në pajtim me këtë ligj nuk lejohet ankesa. Në rastin konkret nuk është zhvilluar ndonjë procedurë sipas padisë për anulimin e vendimit të arbitrazhit nga debitori por sipas propozimit për shpalljen të ekzekutueshëm të vendimit të arbitrazhit konform Nenit 38.1 të Ligjit për Arbitrazhin, andaj bazuar në dispozitën e lartëcituar (Neni 37.3) kundër vendimit të marrë nga gjykata në këtë procedurë nuk lejohet ankesa dhe vendimi bëhet përfundimtar dhe nuk mund të kontestohet në një procedurë tjetër gjyqësore, andaj rrjedhimisht nuk mund të ushtrohet asnjë mjet juridik me të cilin do të atakohej përmbartimi i vendimit të arbitrazhit i cili është njohur dhe është shpallur i ekzekutueshëm.

Të njëjtën e parasheh edhe Ligji nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, i cili në asnjë rast nuk ka paraparë ndërprerjen e procedurës përmbartimore në procedurën e përmbartimit të vendimit të arbitrazhit. Neni 35 i LPP-së, përcakton në mënyrë shteruese rastet e ndërprerjes së procedurës përmbartimore por nuk parasheh ndërprerjen e procedurës së përmbartimit të vendimit arbitrazhit. Ligji nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, të vetmen mundësi për debitorin në procedurën e përmbartimit të vendimit të arbitrazhit e parasheh me dispozitën e Nenit 61, paragrafin 1.2 , sipas të cilës debitori mund të kërkojë shtyerjen e përmbartimit me kusht që gjykatës t'i ketë parashtruar kërkesë për të anuluar vendimin e Arbitrazhit në pajtim me Ligjin e Arbitrazhit dhe pasi ta ketë dhënë garanci shumë e cila korrespondon me shumë e kërkesës. Në rastin konkret nuk është parashtruar padi për anulimin e vendimit të arbitrazhit të huaj, vendimi është njohur dhe është shpallur i ekzekutueshëm nga gjykata kompetente me vendim përfundimtar dhe juridikisht të pa-atakueshëm, andaj i njëjti nuk mund të atakohet në procedurën e përmbartimit. Mbi këtë bazë kjo gjykatë ka gjetur se Konkluzioni PPP.nr.90/20 dt.23.06.2020, i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me të cilin është pezulluar procedura, deri sa të përfundoj procedura e likuidimit ndaj debitorit të përmbartimit Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP),Autoriteti i

Likuidimit administrator i ....., është pa asnjë mbështetje ligjore dhe jashtë logjikës juridike, sepse pezullohet procedura deri në likuidimin e AKP-së, e cila nuk është dhe nuk mund të jetë në procedurë të likuidimit.

Gjykata vlerësoi Konkluzionin e atakuar të shkallës së parë sa i përket bazueshmërisë së prapësimit të debitorit përmbarimor dhe gjeti se konstatimet e gjykatës së shkallës së parë janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës, sepse nga dokumentet e bashkangjitura të cilat nuk i ka trajtuar fare gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e konkluzionit të atakuar, rezulton se debitori ka aprovuar raportin për shpërndarjen përfundimtare për kreditorin N.SH..... publikuar në faqen zyrtare të AKP-së, i cili fakt e argumenton të kundërtën e konstatimit të shkallës së parë se debitori gjendet në likuidim. Për më tepër edhe po të mos kishte përfunduar procedura e likuidimit debitori ka qenë i obliguar që kërkesën e kreditorit nga vendimi i arbitrazhit ta regjistrojë si kërkesë preferenciale në procedurën e likuidimit dhe ta përmbush atë me prioritet. Pezullimi i paraparë me Nenin 10 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ka për qëllim mundësimin e paraqitjes dhe realizimit të kërkesave të kreditorëve në procedurën e Likuidimit pa pasur nevojë që kreditorët t'i nënshtrohen procedurës gjyqësore dhe i referohet fazës kur kreditorët mund ti paraqesin kërkesat e tyre, por pas kalimit të kësaj fazë dhe për kërkesat e pamaturuara në këtë fazë, e të cilat nuk kanë hyrë në listën e kërkesave të aprovuara nuk mund të kërkohej apo urdhërohet pezullimi. Nga shkresat e lëndës nuk rezulton se kërkesa e kreditorit gjendet në listën e kërkesave të miratuara në procedurën e likuidimit andaj e vetmja mundësi për kreditorin për realizimin e kërkesës të vërtetuar nga arbitrazhi ndërkombëtar dhe nga gjykata vendore është përmes procedurës përmbarimore në të kundërtën me pezullimin e procedurës përmbarimore deri në shuarjen e plotë të debitorit atij, do ti pamundësohej plotësisht mundësia e realizimit të kërkesës.

Bazuar në të sipërcekurat dhe në përputhje me dispozitat e Nenit 77 dhe 17 të LPP-së lidhur me nenin 208 dhe 209 të LPK-së, si dhe nenit 195 par.1, pika b), të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e Shkallës së dytë

Kom.Dh.Shk.II.nr.1340/22

Gjyqtari  
Krenar Berisha